REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQËNIES SOCIALE**
**QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE**
**DREJTORIA E FINANCES INVESTIMEVE DHE BUXHETIT**

Nr.140 Prot Tiranë, më 24 . 02 2026

**Lënda: Raporti i Monitorimit të Buxhetit për vitin 2025**

**MINISTRISE SE SHENDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**
**Rruga e Kavajës, Tiranë**

Në mbështetje të Ligjit nr.115/2024, " Për buxhetin e vitit 2025", I ndryshuar ,AN nr.11,datë 19.12.2025", Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit,, i ndryshuar , Udhëzimit plotësues nr.2, datë 24.01.2025" Për zbatimin e buxhetit 2025", Udhëzimit nr. 14. date 30/05/2023" Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore", lutemi gjeni bashkëlidhur raportin e Monitorimit të Buxhetit të vitit 2025 për QKUM-në si dhe në mbështetje të Ligjit 147/2014, "Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore"

Raporti i monitorimit i vitit 2025, krahas analizes së shpenzimeve buxhetore , përmban dhe një analizë të objektivave institucionale të performancës buxhetore të orientuara drejt rezultateve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj!

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**
**Skënder Brataj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - QENDRA KOMBËTARE E URGJENCËS MJEKËSORE - TIRANË - MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Adresa: Rruga Lord Bajron nr.70 Laprakë ,Tiranë, Albania, ëëë.urgjenca.gov.al, e mail:info@urgjenca.gov.al

**RAPORTI I SHPENZIMEVE FAKTIKE SIPAS ARTIKUJVE PËR VITIN 2025,,**

Qëndra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore, nëpërmjet planifikimit, drejtimit, pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem mbarështetëror të unifikuar, si dhe bashkërendimin e veprimtarisë me sistemet e ngjashme në vendet fqinje.

QKUM ka kryer monitorimin e buxhetit për vitin 2025, nëpërmjet vlerësimit të performancës së fondeve buxhetore dhe krahasimit të treguesve faktik të performancës me ato të planifikuara. Nëpërmjet këtij raporti monitorimi evidentohen niveli i realizimit të fondeve buxhetore të QKUM-së të detajuara në nivel kategori shpenzimi buxhetor kundrejt treguesve të planifikuar .
Mbulimi i prioriteteve të institucionit të QKUM me fondet e mjaftueshme buxhetore i siguron institucionit qëndrueshmërinë dhe integritetin e nevojshëm për arritjen e rezultateve që përmirësojnë jetën e qytetarëve. Në zbatim të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "*Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qëndrore*", Institucioni i QKUM-së për 12-mujorin e vitit 2025 ka menaxhuar dhe vlerësuar me përparësi të veçantë procesin e monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore. Proçesi i monitorimit ofron informacion të detajuar mbi ecurinë e zbatimit të buxhetit dhe mbulon periudhën 1 janar 2025 deri më 31 dhjetor 2025. Analiza e raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit 12-mujor i mundëson institucionit orientimin dhe sigurimin e një informacioni shtesë për të përmirësuar proçesin e planifikimit dhe të menaxhimit të buxhetit.
Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit përfshin performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar per vitin 2025.

Buxheti i QKUM-së për vitin 2025 është miratuar me ligjin nr. 115/2024, me një plan fillestar te celur ne vlerën 627,543,000 lekë, nga ku shpenzimet korrente jane alokuar me shkresën e MSHMS nr. 337, datë 21.01.2025 në vlerën prej 466,543,000 lekë dhe shpenzimet kapitale në vlerën prej 161,000,000 lekë, alokuar me shkresën nr. 353/4 prot, datë 12.02.2025. Gjatë 12-mujorit të vitit 2025, ky plan ka pësuar ndryshime si rezultat i përfitimit të fondeve buxhetore me, rishpërndarja e fondeve,transferime dhe rishikim të buxhetit vjetor me Aktin Normatin nr. 6 datë 11.06.2025 dhe AN nr 11,dt 19 /12.2025 të paraqitur në mënyrë të përmbledhur, sipas tabelës më poshtë:

| | | | | | | | | | në 000/ lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Artikulli** | **Programi** | **Fakti 2024** | **Plan Fillestar V.2025** | **Plan I RishikuarAN nr.6,dt 11.06.2025,** | **Plan I Rishikuar AN nr /12.2025** | **Plan në fund të V.2025** | **Fakti V 2025** | **Diferenc** | **Nw%** |
| 600 | Paga | 127699 | 136249 | 24149 | -21750 | 138648 | 136838 | 1810 | 99% |
| 601 | Sigurime shoqerore e shendetesore | 21225 | 23,281 | 2900 | -2430 | 23751 | 22725 | 1026 | 96% |
| 602 | Shpenzime për mallra dhe sherbime të tjera | 105906 | 306613 | -96380 | -70000 | 140233 | 135088 | 5145 | 96% |
| 606 | Transferta te individet | 740 | 400 | | -200 | 200 | 170 | 30 | 85% |
| **Nën Tota** | **Shpenzimet Korrente** | **255570** | **466543** | **-69331** | **-94380** | **302832** | **294821** | **8011** | **97%** |
| 231 | Ndertim i godines se re të back up të QKUM | | 80000 | | | 80,000 | 46420 | 33,580 | **58%** |
| 231 | Paisje mjekesore | 8340 | | | | | | 0 | |
| 231 | Rishikim projekti ndertim I godines se re Bach up | | | 596 | | 596 | 596 | 0 | **100%** |
| 231 | supervizim + kolaudim | | 1000 | | | 1000 | 512 | 488 | **51%** |
| 231 | Blerje mobilje zyrash | 801 | | | | | | 0 | |
| 231 | Blerje paisje IT kompjutera | | | 13000 | | 13000 | 600 | 12,400 | **5%** |
| 231 | Blerje autoambulanca per sherbimin e urgjences per QKUM | | 80000 | 100000 | -180000 | 0 | 0 | 0 | |
| **Nën Tota** | **Shpenzime me Financim të Brendshem** | **9141** | **161000** | | **-180000** | **94596** | **48128** | **46468** | **51%** |
| | **TOTAL** | **264711** | **627543** | | | **397428** | **342949** | **54479** | **86%** |

Nga të dhënat e tabelës vihet re se, buxheti fillestar për vitin 2025 ka ndryshuar për sa më poshtë:

- -Shtuar shpenzimet korrente, në vlerën prej 27,049,000 lekë si rezultat i transferim fondi per paga , sigurime shoqerore për vitin 2025, miratuar me shkresën nr. 2697/3 datë 17.07.2025.
- -Paksuar shpenzimet korrente, në vlerën 145,180,000 leke, me shkresen nr 3873.prot ,datë 03.10.2025, Shkresa MSH nr.4478, date 14.11.2025
- -Me Aktin Normativ Nr.6 datë 11.06.2025"*Për disa ndryshime e shtesa në ligjin Nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025",* është shtuar plani i buxhetit në vlerën prej 100 milion lekë ,shpenzime kapitale, Financim i Brendshëm" Blerje autoambulanca per sherbimin e urgjences per QKUM,,

- F.V paisje elektronike për njesine e kordinimit te QKUM, me shkresën e MSHMS nr 1705/7 dt 30.07.2025, u celën 13,000,000 lekë,

- Paksuar ne Aktin normativ nr.11,dt 19.12.2025 në vlerën 180,000,000 lekë. " Blerje autoambulanca per sherbimin e urgjences per QKUM,,

## ANALIZA E REALIZIMIT TE BUXHETIT TË QKUM-SË PËR VITIN 2025

Krahas ndjekjes së planit, Q.K.U.M ka ndjekur me përparësi edhe realizimin e fondeve buxhetore ndaj planit të miratuar, të detajuar në nivel treguesish të performancës.

Në 12-mujorin e vitit 2025, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit në artikuj, krahasuar me planin, paraqitet si më poshtë

### 1-Pagat dhe Sigurimet Shoqërore dhe Shendetësore, llogaria 600-601

**1-Në zërin 600-601,**

Në zërin Paga dhe Sigurime Shoqërore e Shëndetësore ,për vitin 2025, në fillim të vitit janë celur 159,530 mijë lek.

- Me shkresën e MSHMS nr.337, datë 21.01.2025, në zerin e pagave dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë alokuar në buxhetin e vitit 2025 transferim fondi ne vleren 27,049,000 leke.
- Paksuar shpenzimet për pagat dhe sigurime ,në vleren 24,180,000 leke, me shkresen nr 3873.prot,datë 30.10.2025.
- Për vitin 2025 buxheti me ndryshime, i planifikuar , në zërin Paga dhe Sigurime Shoqërore e Shendetësore është në vlerën 162,399 ,000 lek, është realizuar në vlerën 159,563,000 lekë ose në masën 98%.
- Numri i punonjësve sipas strukturës në organikë i planifikuar gjatë Vitit 2025 ka qënë 118 (njëqindetetembedhjetë) , ndërkohë të punësuar në vitin 2025 janë 116 punonjës të punësuar pranë QKUM-së.

### 2- Shpenzimet për Mallra e Shërbime të tjera, Llogaria 602

Në lidhje me (Art.602) Shpenzime Korrente listojmë më poshtë realizimin e shpenzimeve sipas natyrës, bazuar dhe në planifikimin e fondeve në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.

Plani me ndryshime pergjate vitit 2025 është në vleren 140,033,000 mije leke dhe shpenzimet faktike ne kete artikull janë në vlerën 135,089,000 leke ose ne masen 96%.

- Peshën më të madhe të këtyre fondeve e zë “Blerje Set Uniforma” në vlerën 31.563,000 lekë, për paisjen e personelit të urgjencës mjekësore të Spitaleve Rajonale dhe Bashkiake, duke realizuar objektivin e vitit 2025.

- Një zë në realizimin e buxhetit të vitit 2025, zë shpenzimi per “Blerje sete të urgjencës mjekësore” në vlerën 28,580,000 lekë

- Buxheti u realizua dhe për zërat “Shërbimi Ruajtjes dhe sigurisë fizike në ambjentet e QKUM-së” në vlerën 17,436,000 lekë me (kontratë 2023-2025 me Illyrian Guard sh.a) dhe kontrata 2025-2026 e cila është në vazhdim për Vitin 2026

- Gjithashtu u krye "Sigurimi i ndërtesës dhe aseteve të Q.K.U.M-së" në vlerën 5,700,000 lek.
- Shpenzimet për "Shërbim GPS dhe monitorim për autoambulancat" në vlerën 8,981,000 lekë
- Blerje karburant ne vlerën 3,559,000 lekë, sherbim automjetesh ne vleren 1,068,000 lekë dhe shpenzime të tjera të realizuara si shpenzime për, riparim e mirëmbajtje, shërbime të ndryshme, shpenzime udhëtimi e dieta,energji, telefon, etj, blerje materiale, pastrimi, hidraulike, elektrike, etj

**3- Transferta për buxhetet familjare, Llogaria 606**

Në buxhetin e vitit 2025, në llogarinë 606, Fondi i vecante, janë celur në vlerën 200,000 lek, për shpenzimet për daljen në pension të punonjësve dhe ndihma në rast sëmundje dhe fatkeqësie në familje.
Shpenzimet e planifikuara në buxhetin e vitit 2025 janë shpenzuar 170,000 lekë për raste sëmundje dhe raste fatkeqësie në familje.

**4-Shpenzime për investime kapitale, Llogaria 230-231**.Financim i Brendshem

Bazuar në Buxhetin fillestar të vitit 2025, për zërin Investime me financim të brendshëm, me shkresën e MSHMS nr353/4Prot ,dt 12.02.2025, u akordua fondi prej 161,000,000 lekë për artikullin 231 në zërat :

- Ndërtimin e godinës së re të QKUM back up Vlorë, ne vlerën 80,000,000 lekë.
- Supervizim + kolaudim per Ndertim i godines se re të back up të QKUM në vlerën 1,000,000 lek
- Blerje Autoambulanca ne vleren 80.000,000 leke

- Ndryshimet e fondeve te zeri Investime kapitale me financim te brendshëm pergjatë vitit 2025 janë:

- Shtesa në zërin "Blerje autoambulanca për sherbimin e urgjencës për QKUM", me AN nr.6,date 11.06.2025u akordua fondi prej 100,000,000 leke
- Paksuar me Aktin normativ nr.11,dt 19.12.2025 në vlerën 180,000,000 lekë.
- F.V paisje elektronike për njesine e kordinimit te QKUM, me shkresën e MSHMS nr 1705/7 dt 30.07.2025, u celën 13,000,000 lekë,

Duke u mbeshtetur te Buxheti fillestar për QKUM , si dhe me ndryshimet e buxhetit përgjatë vitit 2025, plani i buxhetit dhe realizimi sipas zerave , për artikullin 230-231 sipas kodeve të projektit, paraqitet si më poshtë :

000/lek

| Kodi I projektit | Emertimi | Plan Fillestar | Shtesat | Paksimet | Plani I rishikuar Viti 2025 | Fakt | Ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 20AE102 | Ndertimin e godines se re Back UPVlore | 80000 | | | 80000 | 46420 | 58% |
| 22AC664 | Projekt preventiv zbatimi per ndertimin e godines se re Back UPVlore | | 596 | | 596 | 596 | 100% |
| 20AE103 | Superv+kolaudim per te godines se Re Back UP Vlore | 1000 | | | 1000 | 512 | 51% |
| 22AE209 | Blerje pajisje IT kompjutera | | 13000 | | 13000 | 600 | 5% |
| 18BB181 | Blerje autoambulanca per sherbimin e urgjences per QKUM | 80000 | 100000 | 180000 | 0 | 0 | |
| | | 161000 | 113596 | 180000 | 94596 | 48128 | 51% |

- - **Në zërin blerje për autoambulancat**,në buxhetin fillestar me shkresen e MSHMS nr./4353 date 12.02.2025 u celën 80,000,000 leke,me AN ,Nr.6 datë 11.06.2025"*Për disa ndryshime e shtesa në ligjin Nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025"* akordua fondi për autoambulanca shtese 100,000,000 lekë
- Paksuar me AN nr 11. Date 19.12.2027 është pakësuar për 180,000,000 lekë

Për këtë projekt kërkesa e dërguar për prokurim pranë OBP-së, si fatura e likuiduar e lëshuar nga OBP për realizimin e procedurës, në zbatim të VKM-së nr. 245, datë 17.04.2024 "*Për përcaktimin dhe përllogaritjen e tarifës për kryerjen e veprimtarive ndihmëse për prokurimin publik nga shoqëria aksionare shtetërore "Operatori i Blerjeve të Përqendruara" ShA*").
Kjo procedure nuk perfundoi brenda vitit 2025, duke kaluar në disa faza, ankimimi, gjë që çoi në pakësimin e fondeve
Kjo proçdurë do të vazhdojë në Vitin 2026

- **Procedura *"Blerje Kompjutera për QKUM"*** *u akorduan fondi prej 13,000,000 lekë, proçedurë e zhvilluar* nga AKSHI, u finalizua me lidhjen e kontratës me Operatorin ekonomik. Por kontrata nuk u realizua, pasi OE nuk arriti të dorëzonte mallin sipas specifikimeve dhe brenda afatit të përcaktuar në kontratë. Duke qenë se kontrata u lidh në muajin dhjetor, pasi atëherë erdhi autorizimi për lidhje kontrate nga AKSHI dhe përfundonte viti buxhetor, e kishim të pamundur shtyrjen e afatit të ekzekutimit të kontratës.

- **Ndërtimi i godines se re të back up të QKUM**

Ndërtimin e godinës së re të QKUM back up Vlorë, u alokuan fondet me sh ne vlerën 80,000,000 lekë në planin fillestar shkresën e MSHMS nr./4353 date 12.02.2025

Realizimi i zerit te investimit ne masën 58%, si pasoje e volumeve shtesë të paparashikuara në Preventiv

Kontrata me objekt "Ndërtimi i Godinës së Re Back Up për QKUM në ambjentet e Spitalit Rajonal Vlorë",

Punimet në objektin QKUM Vlorë kanë filluar në datën 04/09/2026, në përputhje me grafikun e miratuar të punimeve dhe dokumentacionin teknik të projektit.Gjatë fazës fillestare të zbatimit, konkretisht në procesin e gërmimeve për realizimin e elementëve të themeleve (plinta dhe trarë lidhës), sipas projektit të miratuar ishte parashikuar hapja e gropave vetëm në zonat ku do të realizoheshin plintat dhe trarët lidhës.

Megjithatë, gjatë kryerjes së gërmimeve u konstatuan struktura betoni ekzistuese (ndërtim ekzistues) në zonën ku ishte parashikuar realizimi i themeleve të reja. Si pasojë e kësaj situate të paparashikuar në projekt, u bë e nevojshme:

· Hapja e plotë e gropës në të gjithë perimetrin e objektit;

· Prishja dhe largimi i betonit ekzistues;

· Pastrimi dhe përgatitja e sipërfaqes për fillimin e punimeve të reja sipas projektit.

Këto punime shtesë u realizuan me qëllim krijimin e kushteve të përshtatshme teknike për zbatimin korrekt të projektit strukturor dhe garantimin e qëndrueshmërisë së objektit.

Pas përfundimit të prishjes së strukturave ekzistuese dhe sistemimit të gropës së gërmimit, punimet kanë vijuar normalisht sipas projektit dhe grafikut të punimeve.

Per këto arsye fondet e parashikuara për Vitin 2025 u realizuan në masën 58%

- **Në zërin Financim i Huaj**, mbështetur në ligjin nr. 37/2015 për "Ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë, në kuadër të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPA II, Marreveshjen e Financimit nr.118, datë 02.03.2023, të nënshkruar nga Qëndra kombëtare e Urgjencës Mjekësore dhe **Spitali Politeknik Bari (si struktura leader i këtij projekti).**

Për Projektin Interreg- IPA CBC Italy,-Albania-Montenegro 2014/2020, me titull: "*Promoting eHealth in cbc Area by Stimulating local Economies* " u disbursuan fondet nga donatoret e financimit të huaj, ne muajin Dhjetor 2025, në vlerën 27,862,893 lekë fonde të cilat do të përdoren për rikthimin e fondeve në buxhet të shtetit, për shpenzime të parafinancuara nga buxheti dhe shpenzime te tjera të realizuara në kuadër të këtij projekti.

## ANALIZA E OBJEKTIVAVE INSTITUCIONALE TE QKUM-së, REFERUAR BUXHETIT TË ORIENTUAR NË REZULTATE

Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është institucioni përgjegjës për zhvillimin e sistemit të shërbimit të urgjencës mjekësore, nëpërmjet planifikimit, drejtimit,

pjesëmarrjes dhe bashkërendimit të të gjitha aseteve ekzistuese në një sistem mbarështetëror të unifikuar, si dhe bashkërendimin e veprimtarisë me sistemet e ngjashme në vendet fqinje.

1. QKUM koordinon dhe kontrollon cilësin e shërbimit në kujdesin parësor,paraspitalor të spitaleve, bën vlerësimin,trajtimin dhe transportin me me mjetet që ka në dispozicion si mjete rrugore, malore, detare, ajrore për në urgjencën spitalore (autoambulancë, automedika, motor ambulancë, helikopter, mjete transporti detare e tjer)
2. Koordinon, asiston dhe monitoron ndihmën e parë për cdo person në kushtet e urgjencës mjekësore, duke filluar nga vendi i ngjarjes.
3. Siguron kujdesin mjekësor të specializuar për cdo person në kushtet e urgjencës mjekësore.
4. Siguron ndihmën e parë dhe kujdesin mjekësor të specializuar në raste të emergjencave shëndetësore dhe civile, nëpërmjet sistemit të koordinimit, pranë Njësisë së Koordinimit të Urgjencave Mjekësore në QKUM.
5. Siguron transportin tokësor, malor, ajror dhe ujor të përshtatshëm për shpëtimin e jetës, ofrimin e kujdesit shëndetësor në kushtet e urgjencës mjekësore dhe transferimin në strukturat e specializuara.
6. Ushtron kontrollin e brendshëm të strukturave të shërbimit të urgjencës mjekësore;
7. Siguron trajnim të vazhdueshëm për personelin shëndetësor dhe joshëndetësor, përfshirë këtu trajnimin klinik dhe programe të trajnimit të vazhdueshëm;

- Treguesit e performances
- Në nivel objektivi, për vitin 2025 kemi këta tregues kyç të performancës:

Në nivel qëllimi të politikës së programit janë parashikuar 2 tregues performance, e konkretisht:

- Uljen e kohës mesatare e mbërritjes së autoambulancave
- Numri i misioneve për ndihmë mjekësore.

| | |
|---|---|
| Koha e adresimit të thirrjes për ndihmë mjekësore urgjente (minuta) | 3 min 05 s |
| Numri i jeteve te shpetuara si pasoje e reagimit ne kohe te sherbimit te urgjences | 15,510 |
| Numri i thirrjeve për urgjenca mjekësore i adresuar në njësitë e Urgjencës Mjekësore | 441,042 |
| Koha mesatare e Reagimit (minuta) | 19.52 |
| Numri i misioneve te urgjences paraspitalore | 143,437 |
| Numri i misioneve te UM ne vendngjarje | 69,496 |

| | |
|---|---|
| Numri i misioneve te UM qe dergohen ne spital | 73,941 |

***<u>Analiza e treguesve të performances</u>***

Koha e adresimit të thirrjeve për ndihmë mjekësore urgjente rezultoi 3 minuta e 05 sekonda, kundrejt 2 minutave e 15 sekondave të parashikuara, duke reflektuar rritjen e ngarkesës operacionale gjatë vitit.

Numri i jetëve të shpëtuara arriti në 15,510, duke tejkaluar parashikimin prej 12,977, çka dëshmon për efektivitet më të lartë të ndërhyrjeve dhe reagim më të koordinuar të shërbimit të urgjencës.

Numri i thirrjeve për urgjencë mjekësore ishte 441,042, më i ulët se parashikimi prej 467,702, duke treguar orientim më të mirë të rasteve drejt konsultave mjekësore dhe përdorim më racional të burimeve.

- Koha mesatare e reagimit u regjistrua në 19 minuta e 52 sekonda, krahasuar me 18 minuta e 26 sekonda të planifikuara, si pasojë e kompleksitetit të rasteve dhe shpërndarjes territoriale të misioneve.

- Numri i misioneve të urgjencës paraspitalore arriti në 143,437, duke tejkaluar parashikimin prej 140,087, çka reflekton rritje të angazhimit operacional dhe mbulim më të gjerë të rasteve urgjente në terren.

Gjatë analizës së treguesve të performancës për shërbimin e urgjencës mjekësore rezulton një panoramë e dyfishtë: nga njëra anë rritje e qartë e efektivitetit klinik dhe operacional, dhe nga ana tjetër sfida strukturore që ndikojnë në kohën e reagimit dhe mbulimin optimal të territorit.

Koha e adresimit të thirrjeve ishte 3 minuta e 05 sekonda, krahasuar me 2 minuta e 15 sekonda të planifikuara. Ky devijim lidhet drejtpërdrejt me rritjen e ngarkesës operacionale, kompleksitetin e rasteve dhe intensitetin e komunikimeve në qendrën e koordinimit. Megjithatë, numri i jetëve të shpëtuara arriti në 15,510, duke tejkaluar ndjeshëm parashikimin prej 12,977. Ky tregues konfirmon rritje të cilësisë së ndërhyrjes, koordinim më të mirë të ekipeve në terren dhe eficiencë më të lartë klinike, pavarësisht sfidave strukturore.

Numri i thirrjeve (441,042) rezultoi më i ulët se parashikimi (467,702), çka sugjeron orientim më të mirë të rasteve drejt kujdesit parësor dhe përdorim më racional të shërbimit të urgjencës. Kjo mund të reflektojë ndërgjegjësim më të mirë të popullatës dhe filtrimin më efikas të thirrjeve.

- Koha mesatare e reagimit ishte 19 minuta e 52 sekonda, kundrejt 18 minuta e 26 sekondave të planifikuara. Arsye kryesore mbetet shpërndarja territoriale e misioneve, infrastruktura rrugore, por sidomos vonesat në dorëzimin e pacientëve në urgjencën e QSUT, ku mesatarja e pritjes kalon 1 orë dhe në raste ekstreme arrin deri në 6 orë. Kjo situatë mban të angazhuara ekipet dhe mjetet, duke ulur

disponueshmërinë për misione të tjera dhe duke rritur kohën reale të ndërhyrjes në terren.

- Numri i misioneve (143,437) tejkaloi planifikimin (140,087), duke treguar rritje të angazhimit operacional dhe mbulim më të gjerë të rasteve urgjente.

Problematikat strukturore për vitin 2025 përfshijnë:
Postacione të paplotësuara me staf mbështetës sipas urdhrit të vitit 2017 (Vau Dejës, Bushat, Theth – mungesë shoferësh; Velipojë operative vetëm sezonal).
Reduktim të postacioneve funksionale në Spitali Rajonal Durrës (nga 5 në 2–3 për shkak të mirëmbajtjes së mjeteve).
Variacion sezonal në Spitali Rajonal Vlorë (5 postacione në verë, 3 në dimër).
Probleme të vazhdueshme mirëmbajtjeje në QSUT dhe Spitali Universitar Shefqet Ndroqi.
Vonesa sistemike në dorëzimin e pacientëve në QSUT, që ndikojnë negativisht në ciklin operacional të autoambulancave, si në Tiranë ashtu edhe në rrethe.
Arsyetimi i përgjithshëm:
Treguesit klinikë dhe operacionalë dëshmojnë rritje të performancës së shërbimit, veçanërisht në shpëtimin e jetëve dhe numrin e misioneve të realizuara. Megjithatë, devijimet në kohën e adresimit dhe reagimit lidhen kryesisht me faktorë strukturorë: mungesë stafi mbështetës, reduktim të postacioneve aktive, mirëmbajtje të pamjaftueshme të flotës dhe mbingarkesë në urgjencat spitalore, sidomos në QSUT.
Në thelb, sistemi po performon mbi kapacitetin e planifikuar, por kërkon:

- Plotësim të menjëhershëm të stafit sipas hartës së miratuar.
- Plan të strukturuar mirëmbajtjeje për flotën.
- Riorganizim të fluksit të pranimit në urgjencat spitalore.
- Mekanizma për shkurtimin e kohës së dorëzimit të pacientëve.

Pa adresimin e këtyre elementeve, rritja e mëtejshme e volumit të punës rrezikon të ndikojë drejtpërdrejt në kohën e reagimit dhe në sigurinë e pacientit, pavarësisht përkushtimit dhe profesionalizmit të ekipeve në terren.

-Gjate vitit 2025, në QKUM, janë kryer një sërë trajnimesh dhe aktivitete me pjesëmarrje të gjerë të Mjekeve dhe Infermjereve nga Spitalet e Republikës së Shqipërisë, Qëndrave Shëndetësore, Poliklinikave, Mjek Specialist, stafi urgjencave, Mjek familje, të studenteve të Universitetit të Sporteve si dhe jane zgjeruar tematikat e trajnimeve si më poshtë:

- Në vitin 2025 janë kryer 15 trajnime
- Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 janë zhvilluar 15 trajnime dhe janë trajnuar 442 Pjesëmarrës ( 79 Mjek + 234 Infermier ) dhe 129 personel jo mjekesor).
  nga të gjitha Spitalet e Republikës së Shqipërisë, Qenrave Shendetësore, Poliklinikave, Mjek Specialist, stafi urgjencave, Mjek familje etj..
- Janë kryer 8 tema të ndryshme ku. Ndër temat përmendim; PHTLS, AMLS, BLS&D, Life Guard, Dhënia e ndihmës së parë, FOTS, EKG,PTACLS, GBRN.

**Disa nga Aktivitetet e kryera përgjatë vitit 2025 jane si më poshtë :**

- Trajnim BLS-T Basic Life Support- Telefonik (Telekomunikimi I reanimacionit kardiopulmonar) me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të QKUM-së"
- Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrilation në bashkëpunim me Urdhërin e Infermierit dhe pjesëmarrjen e personelit infermieror të Qendrave Shëndetësore"
- Trajnim PHTLS Pre-Hospital Trauma Life Support, me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të spitaleve rajonale"
- Trajnim BLS&D Basic Life Support & Defibrilation
- Trajnim PTACLS (Principles and Techniques of Advanced Cardiac Life Support), me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të Qendrave Shëndetësore dhe spitaleve"
- Trajnim ""Dhënia e ndihmës së parë""(Imobilizimi, Transporti I pacientëve traumatik në terren të vështirë) me pjesëmarrjen e Forcat e Armatosura
- Kursi CBRN (Chemical, Biological, Radiological and Nuclear), në kuadër të projektit P88 EU CBRN CoE me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të spitaleve dhe institucioneve të ndryshme shëndetësore"
- Kursi Lifeguard- BLS&D Basic Life Support &Defibrilation me pjesëmarrjen e studentave të Universitetit të Sporteve."
- Kursi Lifeguard- BLS&D Basic Life Support &Defibrilation me pjesëmarrjen e studentave të Universitetit të Sporteve."
- Kursi CBRN (Chemical, Biological, Radiological and Nuclear), në kuadër të projektit P88 EU CBRN CoE me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të spitaleve dhe institucioneve të ndryshme shëndetësore"
- Trajnim BLS&D Basic Life Support &Defibrilation me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të Qendrave Shëndetësore"
- Trajnim PHTLS Pre-Hospital Trauma Life Support, me pjesëmarrjen e personelit mjekësor të spitaleve dhe qendrave shëndetësore".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**
**Skënder Brataj**

Periudha e Raportimit 12-2025

# ANEKSI nr.1 Raporti Përmbledhës i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit Buxhetor

në/lekë

| Emri i Grupit | | Kodi i grupit 13 | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| EMËRTIME | | Shpenzimet e/Institucionit te QKUM-SW | | | | | | | | | | |
| | | Viti paraardhës 2024 | | Periudha raportuese | | Periudha raportuese | | Periudha raportuese | Periudha raportuese | | Ndryshimi Vjetor | |
| | | Shpenzime Faktike | Struktura e shpenzimeve në % | Plani Fillestar Vjetor Viti 2025 | Struktura e shpenzimeve në % | Plani Vjetor i Rishikuar AN nr.6, dt.11.06.2025 Viti 2025 | Struktura e shpenzimeve në % | Ndryshimi i planit vjetor | Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive | Struktura e shpenzimeve në % | (Plan - Fakt) | % e realizimit |
| | | -1 | -2 | -3 | -4 | -5 | -6 | 7 (5-3) | -8 | -9 | 10 (5-8) | 11 ( 8/5) |
| **Shpenzimet sipas programeve buxhetore** | | | | | | | | | | | | |
| Kodi i Programit | Emërtimi | | | | | | | | | | | |
| 7330 | **Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor** | **264,710,568.00** | | **627,543,000.00** | | **397,427,961.00** | | **-230,115,039.00** | **342,949,265.00** | | **54,478,696.00** | **86%** |
| | **Totali i Shpenzimeve buxhetore te Ministrise (Kap 01,02,03,04,05,08,22)** | | | | | | | **0.00** | | | **0.00** | |
| | **Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)** | | | | | | | **0.00** | | | **0.00** | |
| | **Totali Shpenzimeve te QKUM** | **264,710,568.00** | | **627,543,000.00** | | **397,427,961.00** | | **-230,115,039.00** | **342,949,265.00** | | **54,478,696.00** | **86%** |
| **Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik** | | | | | | | | | | | **0.00** | |
| Artikulli | Emërtimi | | | | | | | | | | **0.00** | |
| 600 | Paga | 127,699,516.00 | | 136,249,000.00 | | 138,648,000.00 | | 2,399,000.00 | 136,837,815.00 | | 1,810,185.00 | **99%** |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 21,224,598.00 | | 23,281,000.00 | | 23,751,000.00 | | 470,000.00 | 22,725,290.00 | | 1,025,710.00 | **96%** |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 105,905,514.00 | | 306,613,000.00 | | 140,233,000.00 | | -166,380,000.00 | 135,088,639.00 | | 5,144,361.00 | **96%** |
| 603 | Subvencione | | | | | | | 0.00 | | | 0.00 | |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | | | | 0.00 | | | 0.00 | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | | | | 0.00 | | | 0.00 | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 740,000.00 | | 400,000.00 | | 200,000.00 | | -200,000.00 | 170,000.00 | | 30,000.00 | **85%** |
| | **Nen-Totali Shpenzime Korrente** | **255,569,628.00** | | **466,543,000.00** | | **302,832,000.00** | | **-163,711,000.00** | **294,821,744.00** | | **8,010,256.00** | **97%** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | | | | 0.00 | | | **0.00** | |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | | | | 0.00 | | | **0.00** | |
| 231 | Ndertim I godines se re back up te QKUM | | | 80,000,000.00 | | 80,000,000.00 | | 0.00 | 46,420,029.00 | | 33,579,971.00 | **58%** |
| 231 | Pajisje mjekesore | 8,340,000.00 | | | | | | 0.00 | | | 0.00 | |
| 230 | Rishikim projekti ndertim I godines se re back up | | | | | 595,961.00 | | 595,961.00 | 595,961.00 | | 0.00 | **100%** |
| 231 | Supervizim + kolaudim | | | 1,000,000.00 | | 1,000,000.00 | | 0.00 | 511,531.00 | | 488,469.00 | **51%** |
| 231 | Blerje mobilje zyrash | 800,940.00 | | | | | | 0.00 | | | 0.00 | |
| 231 | Blerje pajisje IT kompjutera | | | | | 13,000,000.00 | | 13,000,000.00 | 600,000.00 | | 12,400,000.00 | **5%** |
| 231 | Blerje autoambulanca per sherbimin e urgjences per QKUM | | | 80,000,000.00 | | | | -80,000,000.00 | | | 0.00 | |
| | **Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te brendshem** | **9,140,940.00** | | **161,000,000.00** | | **94,595,961.00** | | **-66,404,039.00** | **48,127,521.00** | | **46,468,440.00** | **51%** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | | | | 0.00 | | | | |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | | | | | 0.00 | | | | |
| | **Nen-Totali Shpenzime Kapitale me financim te huaj** | | | | | | | 0.00 | | | | |
| | **Totali Shpenzime Kapitale** | | | | | | | 0.00 | | | | |
| | **Totali i Shpenz. Buxhetore te Ministrise/Institucionit Buxhetor** | | | | | | | 0.00 | | | | |
| | **Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit (Kap 06)** | | | | | | | 0.00 | | | | |
| | **Totali (Korrente + Kapitale + Shpenz.nga te ardh.jashte limti** | **264,710,568.00** | | **627,543,000.00** | | **397,427,961.00** | | **-230,115,039.00** | **342,949,265.00** | | **54,478,696.00** | **86%** |
| | **Numri i punonjësve** | 0 | | 118 | | 0 | | | 116 | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Drejtori I i Përgjithshëm | Emri | | |
| | Firma | | |
| | Data | | 22.02.2026 |

Periudha e Raportimit 12-2025

## ANEKSI 1.1 Raporti i Shpenzimeve të Ministrisë/Institucionit sipas kapitujve

| Kodi i Ministrisë | Kodi i Kapitullit | Emërtimi i Kapitullit | Periudha raportuese | Buxheti | Artikujt buxhetore | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 230 | 231 | 600 | 601 | 602 | 603 | 604 | 605 | 606 | Total |
| | | | Periodike /Vjetore | | Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara | Shpenzime Kapitale te Trupëzuara | Pagat | Kontrib.e Sigurimeve Shoqerore | Mallra dhe Shërbime | Subvenci-net | Të Tjera Transfer Korrente Brendshme | Transfer. Korrente të Huaja | Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individet | Total |
| 13 | 01 | Nga Buxheti | 2025 | Plani fillestar | | 161,000,000 | 136,249,000 | 23,281,000 | 306,613,000 | | | | 400,000 | 627,543,000 |
| 13 | 01 | Nga Buxheti | 2025 | Plani i rishikuar | 595,961 | 94,000,000 | 138,648,000 | 23,751,000 | 140,233,000 | | | | 200,000 | 396,832,000 |
| 13 | 01 | Nga Buxheti | 2025 | Fakti | 595,961 | 47,531,560 | 136837815 | 22725290 | 135088639 | | | | 170000 | 342,353,304 |
| 13 | 01 | Nga Buxheti | 2025 | Angazhime | | | | | | | | | | |
| 13 | 02 | Financim i huaj - Grant | 2025 | Plani fillestar | | | | | | | | | | |
| 13 | 02 | Financim i huaj - Grant | 2025 | Plani i rishikuar | | | | | | | | | | |
| 13 | 02 | Financim i huaj - Grant | 2025 | Fakti | | | | | | | | | | |
| 13 | 02 | Financim i huaj - Grant | 2025 | Angazhime | | | | | | | | | | |
| 13 | 03 | Kosto lokale | 2025 | Plani fillestar | | | | | | | | | | |
| 13 | 03 | Kosto lokale | 2025 | Plani i rishikuar | | | | | | | | | | |
| 13 | 03 | Kosto lokale | 2025 | Fakti | | | | | | | | | | |
| 13 | 03 | Kosto lokale | 2025 | Angazhime | | | | | | | | | | |
| 13 | 04 | TVSH, Detyrim Doganor | 2025 | Plani fillestar | | | | | | | | | | |
| 13 | 04 | TVSH, Detyrim Doganor | 2025 | Plani i rishikuar | | | | | | | | | | |
| 13 | 04 | TVSH, Detyrim Doganor | 2025 | Fakti | | | | | | | | | | |
| 13 | 04 | TVSH, Detyrim Doganor | 2025 | Angazhime | | | | | | | | | | |
| 13 | 08 | Granti i Universitarit, | 2025 | Plani fillestar | | | | | | | | | | |
| 13 | 08 | Granti i Universitarit, | 2025 | Plani i rishikuar | | | | | | | | | | |
| 13 | 08 | Granti i Universitarit, | 2025 | Fakti | | | | | | | | | | |
| 13 | 08 | Granti i Universitarit, | 2025 | Angazhime | | | | | | | | | | |
| 13 | | Total | 2025 | Plani fillestar | | 161,000,000 | 136,249,000 | 23,281,000 | 306,613,000 | | | | 400,000 | |
| 13 | | Total | 2025 | Plani i rishikuar | 595,961 | 94,000,000 | 138,648,000 | 23,751,000 | 140,233,000 | | | | 200,000 | |
| 13 | | Total | 2025 | Fakti | 595,961 | 47,531,560 | 136837815 | 22725290 | 135088639 | | | | 170000 | |
| 13 | | Total | 2025 | Angazhime | | | | | | | | | | |
| 13 | | Ndryshimi ne vlere absolute | 2025 | | | 46,468,440 | 1,810,185 | 1,025,710 | 5,144,361 | | | | 30,000 | |
| 13 | | Realizimi ne % | 2025 | | 100% | 51% | 99% | 96% | 96% | | | | 85% | |
| 13 | 06 | Nga të ardhurat jashtë limitit | 2025 | Fakti | | | | | | | | | | |
| 13 | 06 | Nga të ardhurat jashtë limitit | 2025 | Angazhime | | | | | | | | | | |

| Nëpunësi Zbatues | | |
|---|---|---|
| | Emri | |
| | Firma | |
| | Data | 22.02.2025 |

| Drejtori I Përgjithshëm | | |
|---|---|---|
| | Emri | |
| | Firma | |
| | Data | 22.02.2025 |

# Aneksi 1.2 "Shpenzimet Buxhetore në Total Programi dhe Total Ministrie/Institucioni Buxhetor"

**Periudha e Raportimit 12-2025**

| Kodi i Ministris | Kodi i Programi | Emërtimi i Programit | Viti | Tipi i Buxhetit | Art. 230 | Art. 231 | Art. 600 | Art. 601 | Art. 602 | Art. 603 | Art. 604 | Art. 605 | Art. 606 | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | | Te ardhura jashte limiti | 2025 | Shpenzime faktike | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 13 | 07330 | Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor | 2025 | Plani fillestar | 0 | 161,000,000 | 136,249,000 | 23,281,000 | 306,613,000 | 0 | | 0 | 400,000 | 627,543,000 |
| 13 | 07330 | Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor | 2025 | Plani i rishikuar | 595,961 | 94,000,000 | 138,648,000 | 23,751,000 | 140,233,000 | 0 | | 0 | 200,000 | 396,832,000 |
| 13 | 07330 | Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor | 2025 | Shpenzime faktike | 595,961 | 47,531,560 | 136837815 | 22725290 | 135088639 | 0 | | 0 | 170000 | 342,353,304 |
| 13 | 07330 | Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Dytësor | 2025 | Angazhime | | | | | | 0 | | 0 | | 0 |
| 13 | | Ndryshimi ne vlere absolute | 2025 | | | 46,468,440 | 1,810,185 | 1,025,710 | 5,144,361 | 0 | | 0 | 30,000 | 54,478,696 |
| 13 | | Realizimi ne % | 2025 | | 100% | 51% | 99% | 96% | 96% | 0 | | 0 | 85% | 86% |
| 13 | | Te ardhura jashte limiti | 2025 | Shpenzime faktike | | | | | | | | | | |
| 13 | | Ndryshimi ne vlere absolute | 2025 | | | | | | | | | | | |
| 13 | | Realizimi ne % | 2025 | | | | | | | | | | | |
| 13 | | Te ardhura jashte limiti | 2025 | Shpenzime faktike | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 13 | | Total i Ministrisë/Institucionit | 2025 | Plani fillestar | | | | | | | | | | |
| 13 | | Total i Ministrisë/Institucionit | 2025 | Plani i rishikuar | | | | | | | | | | |
| 13 | | Total i Ministrisë/Institucionit | 2025 | Shpenzime faktike | | | | | | | | | | |
| 13 | | Total i Ministrisë/Institucionit | 2025 | Angazhime | 0 | | | | | | | | | |
| 13 | | Numri i punonjesve në Total | 2025 | Plani fillestar | | | | | | | | | | 118 |
| 13 | | Numri i punonjesve në Total | 2025 | Plani i rishikuar | | | | | | | | | | 0 |
| 13 | | Numri i punonjesve në Total | 2025 | Numri faktik | | | | | | | | | | 116 |

| Nëpunësi Zbatues | | |
|---|---|---|
| | Emri | Sloobodo Vesho |
| | Firma | [signature] |
| | Data | |

| Drejtori i Përgjithshëm | | |
|---|---|---|
| | Emri | |
| | Firma | [signature] |
| | Data | |

Periudha e Raportimit 12-2025

## ANEKSI nr. 2 Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit

në/lekë

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emri i Grupit | QKUM | | | Kodi i grupit | | | | 13 | | | | |
| Emri i | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | | | Kodi i programit | | | | 7330 | | | | |
| EMËRTIME | | Shpenzimet e Programit | | | | | | | | | | |
| | | Viti paraardhës 2024 | | Periudha raportuese | | Periudha raportuese | | Periudha raportuese | Periudha raportuese | | | |
| | | Shpenzime Faktike | Struktura e shpenzimeve në % | Plani Fillestar Vjetor Viti 2025 | Struktura e shpenzimeve në % | Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2025 | Struktura e shpenzimeve në % | Ndryshimi i planit vjetor | Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive | Struktura e shpenzimeve në % | Ndryshimi Vjetor ( Plan - Fakt) | % e realizimit |
| | | (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) | 7 (5-3) | (8) | (9) | 10 (5-8) | 11 ( 8/5) |
| Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik | | | | | | | | | | | | |
| 7330 | Emërtimi | | | | | | | | | | | |
| 600 | Paga | 127,699,516.00 | | 136,249,000.00 | 33 | 138,648,000 | 33 | 2,399,000 | 136,837,815.00 | 33 | 1,810,185 | 99 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 21,224,598.00 | | 23,281,000.00 | 28 | 23,751,000 | 28 | 470,000 | 22,725,290.00 | 28 | 1,025,710 | 96 |
| 602 | Malira dhe Shërbime të Tjera | 105,905,514.00 | | 306,613,000.00 | 19 | 140,233,000 | 19 | -166,380,000 | 135,088,639.00 | 19 | 5,144,361 | 96 |
| 603 | Subvencione | | | | 0 | | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | | | | 0 | | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | | | | 0 | | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 740,000.00 | | 400,000.00 | 26 | 200,000 | 26 | -200,000 | 170,000.00 | 26 | 30,000 | 85 |
| | **Nëntotali Shpenzime Korente** | **255,569,628.00** | | **466,543,000.00** | 26 | **302,832,000** | 26 | **-163,711,000** | **294,821,744.00** | 26 | **8,010,256** | 97 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | | 0 | 595,961 | 0 | 595,961 | 595,961.00 | 0 | 0 | 100 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 9,140,940.00 | | 161,000,000 | 2 | 94,000,000 | 2 | -67,000,000 | 47,531,560.00 | 2 | 46,468,440 | 51 |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm** | 9,140,940.00 | | **161,000,000** | 2 | **94,595,961** | 2 | -66,404,039 | **48,127,521.00** | 2 | 46,468,440 | 51 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj** | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| | **Totali i Shpenzimeve Kapitale** | | | 161,000,000 | 2 | 94,595,961 | 2 | -66,404,039 | 48,127,521.00 | 2 | 46,468,440 | 51 |
| | **Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit** | | | 627,543,000 | 25 | 397,427,961 | 25 | -230,115,039 | 342,949,265.00 | 25 | 54,478,696 | 86 |
| | **Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)** | | | | | | | | 0.00 | | | #DIV/0! |
| | **Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)** | | | | | | | | 0.00 | | | #DIV/0! |
| | **Totali i Shpenzimeve të Programit** | | | | | | | | | | | #DIV/0! |
| Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor | | | | | | | | | | | | #DIV/0! |
| Artikulli | Emërtimi | | | | | | | | | | | #DIV/0! |
| | **Totali i Shpenzime Korente** | 255,569,628.00 | | 466,543,000 | 95 | 302,832,000 | 95 | -163,711,000 | 294,821,744.00 | | -8,010,256 | 97 |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | 0 | |
| 91304AP | | | | | | | | | | | 0 | |
| | **Totali Shpenzime për Investime** | 9,140,940.00 | | 161,000,000 | 5 | 94,595,961 | 5 | -66,404,039 | | 0 | -94,595,961 | 0 |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | 0 | | | 0 | |
| 20AE207 | Blerje Mobilje Zyrash | 800,940.00 | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| 18BB901 | Paisje mjekesore | 8,340,000.00 | | | 0 | | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| 20AE102 | Ndertimin e godines se re Back UPVlore | | | 80,000,000 | 3 | 80,000,000 | 3 | 0 | 46,420,029.00 | 0 | -33,579,971 | 58 |
| 22AC664 | Projekt preventiv zbatimi per ndertimin e godines se re Back UPVlore | | | | 0 | 595,961 | 0 | 595,961 | 595,961.00 | 0 | 0 | 100 |
| 20AE103 | Superv+kolaudim per te godines se Re Back UP Vlore | | | 1,000,000 | 0 | 1,000,000 | 0 | 0 | 511,531.00 | 0 | -488,469 | 51 |
| 22AE209 | Blerje pajisje IT kompjutera | | | | 0 | 13,000,000 | 0 | 13,000,000 | 600,000.00 | 0 | -12,400,000 | 5 |
| | Blerje autoambulanca per sherbimin e urgjences per QKUM | | | 80,000,000 | 0 | | 0 | -80,000,000 | | 0 | 0 | |
| | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| | | | | | 0 | | 0 | 0 | | 0 | 0 | |
| | | | | | 1 | | 1 | 0 | | 0 | 0 | |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm** | | | | 5 | | 5 | 0 | | 0 | 0 | |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | 0 | 48,127,521.00 | | 48,127,521 | |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj** | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | 161,000,000 | | 94,595,961 | | -66,404,039 | | | -94,595,961 | 0 |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | 0 | |
| | **Totali i Shpenzimeve të Programit** | **264,710,568.00** | | **627,543,000** | | **397,427,961** | | | **342,949,265.00** | | **-54,478,696** | |

| | | |
|---|---|---|
| **Nepunësi Zbatues** | Emri | |
| | Firma | |
| | Data | |

| | | |
|---|---|---|
| **Drejtori I Pergjithshem** | Emri | |
| | Firma | |
| | Data | |

## ANEKSI nr.3 Raporti i performancës së produkteve të programit

**Periudha e Raportimit 12-2025**

në/lekë

| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emri i Grupit | Qendra Kombetare e Urgjences Mjekesore | | Kodi i grupit | | | | | | | 13 | | | | | | | |
| Emri i | Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi | | Kodi i programit | | | | | | | 7330 | | | | | | | |
| Kodi i Produktit | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Viti paraardhës | | | Periudha Rapotuese | | | Periudha Rapotuese | | | Periudha Rapotuese | | | Deviacioni i Kostos për Njësi | | |
| | | | Sasia Faktike (Viti paraardhës) | Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhes) | Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës) | Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) | Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor | Kosto për Njësi (sipas planit Fillestar të vitit | Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent) | Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent) | Kosto për Njësi(sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent) | Sasia Faktike (në /nfund të vitit korent) | Shpenzimet Faktike /n(në fund të vitit korent) | Kosto për Njësi Faktike n/(në fund të vitit korent) | 13=(12)-(3) | 14=(12)-(6) | 15=(12)-(9) |
| | | | -1 | -2 | -3 | -4 | -5 | -6 | -7 | -8 | -9 | -10 | -11 | -12 | -13 | -14 | -15 |
| Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 20AE207 | Blerje Mobilje Zyrash | | 28 | 800,940.00 | 28,605 | | | | | | | | | | -28,605.00 | | 0.00 |
| 18BB901 | Paisje mjekesore | | | 8,340,000.00 | | | | | | | | | | | 0.00 | | 0.00 |
| 20AE102 | Ndertimin e godines se re Back UPVlore | | | 0 | | | 80,000,000 | | | 80,000,000 | | | 46420029 | | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 22AC664 | Projekt preventiv zbatimi per ndertimin e godines se re Back UPVlore | numer | | 0 | | 1 | | | 1 | 595,961 | 595,961.00 | 1 | 595961 | 595961 | | 595,961.00 | 0.00 |
| 20AE103 | Superv+kolaudim per te godines se Re Back UP Vlore | cope | | | | | 1,000,000 | | | 1,000,000 | | | 511531 | | | 0.00 | 0.00 |
| 22AE209 | Blerje pajisje IT kompjutera | COPE | | | | | | | | 13,000,000 | | | 600,000 | | | 0.00 | 0.00 |
| 18BB181 | Blerje autoambulanca per sherbimin e urgjences per QKUM | COPE | | | | | 80,000,000 | | | 0 | | | | | | 0.00 | 0.00 |
| Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (Nga kapitulli 06) | | 0 | | | | | | | | | | | | | | 0.00 | 0.00 |
| T | Total | | | | | | 161,000,000 | | | 94,595,961 | | | | | | | |

| Nepunesi zbatues | | |
|---|---|---|
| | Emri | |
| | Firma | |
| | Data | 22.02.2026 |

| Drejtor i Përgjithshëm | | |
|---|---|---|
| | Emri | |
| | Firma | |
| | Data | 22.02.2026 |